



Në bazë të Qarkores Buxhetore 2023/01 të Ministrisë për Financa të dt.13 Maj 2022, në bazë të nenit 40.2(b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, sipas nenit 26 pika 2 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, miraton këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE (KAB) PËR KOMUNËN E DEÇANIT PËR VITET 2023-2025

I.

Aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore për Komunën e Deçanit për vitet 2023-2025.

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2023/01, për vitin 2023 është – 12,119,806.00€ (11,021,321.00 nga grantet dhe 1,098,485.00 nga të hyrat vetanake)

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2023/01, për vitin 2024 është – 12,879,621.00€ (11,734,567.00 nga grantet dhe 1,145,054.00 nga të hyrat vetanake)

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2023/01, për vitin 2025 është – 13,413,820.00€ (12,218,616.00 nga grantet dhe 1,195,204.00 nga të hyrat vetanake)

II.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Deçanit për vitet 2023-2025.

III.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti i Buxhetit, Zyra e Kryetarit, Drejtoritë komunale dhe Arhivi i Komunës.

01.Nr. X- 2,

Deçan, dt.30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) lidhur me nenin 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 26 pika 1. dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, sipas Rregullores Komunale për Transparencë të dt.31.01.2020, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PLANIT PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN NË KOMUNË

Neni 1

Me këtë vendim aprovohet Plani për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun në Komunë.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Plani për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun në Komunë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e kryetarit të Komunës, Zyra e Kuvendit të Komunës dhe Zyra për Informim e Komunës së Deçanit.

Neni 4


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive Komunale si dhe Arhivit.

01.Nr.X-3

Deçan, dt.30.06.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Plani për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun në Komuna

Qëllimi i përgatitjes së Planit për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun është përgatitja e dokumenteve, si: lajme, njoftime, thirrje, ankande, raporte financiare dhe dokumente tjera dhe publikimi i tyre në Ueb faqen zyrtare të Komunës, poashtu disa nga këto dokumente mund të dërgohen për publikim edhe në media lokale dhe në ato qendrore.

Duhet cekur që ky plan mund të ketë ndryshime gjatë zbatimit të tij, duke u bazuar në kërkesat që vijnë si nga ana e Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorëve të Drejtorive Komunale si dhe nga Ministritë që bëjnë përcjelljen e punës së zyrës për informim, andaj nuk mund të caktohen me saktësi aktivitetet për secilin muaj, sepse mund të ketë ndryshime varësisht nga kërkesat e udhëheqësve dhe strukturave komunale.

Këtu përjashtim bëjnë disa dokumente dhe data të shënuara të cilat duhet të publikohen në muajt përkatës, sepse publikimi i tyre me vonesë ndikon në performancën dhe transparencën komunale.

Synimi i Planit për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun është rritja e intensitetit të informimit dhe komunikimit në Komunën e Deçanit në raport me qytetarët si dhe orientimi i administratës komunale për informim sa më të drejtë dhe përgjegjshmëri në raport të brendshëm kolegial dhe në ofrimin e shërbimeve karshi qytetarëve, marrëdhënia e shëndoshë dhe korrekte me media dhe përfshirja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Që Plani për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun të arrijë qëllimin dhe efikasitetin e duhur, rol të madh luan edhe marrëdhënia dhe komunikimi i brendshëm i të punësuarëve në institucionet komunale. Prandaj, bashkëpunimi dhe komunikimi në mes të Drejtorive dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë luan rol kyç në rritjen e performancës së punës në komunën tonë.

Zyra për Informim

DALESE-IZLADNA - 0.7.2022	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN - DEÇAN MUNICIPALITY	
K.K. Deçan. As. 22830	
01	05.07.22

Zyra për Informim në Deçan kujdeset për transparencën e qeverisjes lokale në raport me qytetarët dhe siguron pasqyrimin e drejtë të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, Drejtorive dhe të gjitha njësive tjera të ekzekutivit.

Kjo zyrë mban kontakte me përfaqësuesit e mediave , ndërmjetëson dhe bën caktimin e intervistave për shtyp të udhëheqësve komunal .

Poashtu, ndër punët kryesore të Zyrës për Informim është mirëmbajtja e Ueb Faqes së Komunës, në të cilën bëhet publikimi i të gjitha njoftimeve për mbledhjet, vendimet dhe informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet me rëndësi për qytetarët e Komunës.

Ueb Faqja zyrtare e Komunës dhe përdorimi i platformave sociale si mjete kryesore të informimit

Administrimi dhe funksionimi i Ueb faqeve të komunave është i rregulluar me *Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.01/2015 mbi ueb faqet e Institucioneve Publike*.

Si burim kryesor i informacionit është Ueb Faqja zyrtare e Komunës, përmes së cilës ofrohen informatat kryesore sa i përket punëve që zhvillohen brenda Komunës, mbledhjet dhe vendimet e marra nga Kryetari i Komunës dhe nga Kuvendi Komunal, shërbimet që ofrohen në Komunë, aktivitetet e prokurimit, raportet financiare, lajmet, njoftimet, thirrjet, raportet dhe planet e punës si dhe shumë e shumë informacione me interes për qytetarët në funksion të llogaridhënies, përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Përveq Ueb faqes zyrtare, Komuna ka të hapur edhe llogarinë e saj në Facebook si dhe Facebook-u zyrtar i Kryetarit të Komunës me një numër relativisht të lartë të ndjekësve, ku mundohemi që edhe përmes kësaj platforme të ofrojmë informacione të sakta mbi zhvillimet dhe punët e Komunës.

Të gjitha këto informacione të punëve të Komunës bëhen me qëllim të arritjes sa më të lartë të transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies karshi qytetarëve. Kuvendi e ka të miratuar Rregulloren Komunale për Transparencë në bazë të *Udhëzimit Administrativ të MAPL-së 04/2018 mbi Transparencën e Komunave*.

Synimet dhe Objektivat e Zyrës për Informim

Ndër synimet tona kryesore janë mbulueshmëria dhe informimi me kohë i të gjitha aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, të Kuvendit Komunal, të gjitha organizimeve dhe ngjarjeve që janë të rëndësishme dhe në dobi të qytetarëve të Komunës tonë.

E të gjitha këto synojmë t'i arrijmë përmes transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërisë, gjithpërfshirjes e mosdiskriminimit si pika kyçe për arritjen sa më të lartë të bashkëpunimit në mes të komunës dhe qytetarëve të saj pa dallim etnie, gjuhe, gjinie, apo religjioni.

Këto janë ndër pikat kryesore të planit që synojmë t'i realizojmë si Zyre për Informim

- * Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- * Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të organeve kryesore:
 - a)KPF – Komiteti për Politikë dhe Financa;
 - b)Komiteti për Komunitete;
 - c)KKSBB – Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi;
- * Përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve për mbledhjet publike me qytetarë;
- * Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- * Pjesëmarrja (monitorimi), përgatitja e njoftimeve dhe lajmeve lidhur me aktivitetet e ndryshme kulturore dhe historike, siç janë përvjetorët e ndryshëm apo edhe festivalet e ndryshme që organizohen në komunën tonë;
- * Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- * Mbajtja e kontaktit dhe komunikimit të përhershëm dhe të vazhdueshëm me publikun, përkatësisht qytetarët, pranimi i informacioneve të ndryshme nga ata dhe shpërndarja e tyre tek udhëheqësit apo zyrtarët komunal, botimi i tyre në publikimet e ndryshme (fletëpalosje, broshura, gazetatat, revistat, Ueb-faqen e Komunës), mjeteve të informimit publik etj;

* Mbajtja e kontakteve të rregullta me përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik, (vendorë dhe ndërkombëtarë), njoftimi i tyre për të gjitha takimet, ngjarjet, zhvillimet dhe manifestimet që mbahen në Komunë. Në këtë rast mediat informohen së paku 1 javë më parë (dhe një ditë para mbajtjes së ngjarjes) për të gjitha takimet publike me qytetarë;

* Informimi me kohë i mediave për ditën dhe kohën e hapjes së ofertave të tenderëve, në mënyrë që të inkurajohen raportimet në media;

* Menaxhimi i UEB-faqes së Komunës, që nënkupton përditësim të përditshëm dhe efikas të saj, duke i edituar të gjitha informatat e rëndësishme që ndodhin në Kuvendin Komunal dhe në qytet siç janë: lajmet, shpalljet, vendimet, rregulloret, konkurset, ngjarjet kulturore, shënimi i datave të rëndësishme dhe përvjetorëve.

Dt.: 30.06.2022, Deçan

Zyra për Informim



Në bazë të Ligjit Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.29, dt. 01 Korrik 2008), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, sipas nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.06.2022, bie këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN PLANIT PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNË

I.

Formohet grupi punues për hartimin e Planit për Mbrojtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Deçanit 2022-2025, në këtë përbërje: **1. Leotrim Hadergjonaj, nga Asambleja (AAK), 2.Arjan Dobraj nga Asambleja (AAK), 3. Skender Kurmehaj, nga Asambleja (LDK), 4. Bekim Vishaj nga Ekzekutivi dhe 5. Shkelzen Shehu nga Ekzekutivi.** Mbledhjen e parë të Grupit punues e fton Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje Grupi e zgjedhë kryesuesin e vet.

II.

Grupi është përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe ofrimin e informatave të nevojshme gjatë dhe deri në përfundimin e procesit të finalizimit të hartimit të Planit për Mbrojtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore për Komunën e Deçanit 2022-2026

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.

IV.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.X-4

Deçan, dt. 30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (c) dhe nenit 34 paragrafi 34.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019, për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 19 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, bie këtë:

V E N D I M

PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË MODEL - RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

I.

Miratohet Vendimi për vënien në Diskutim Publik të Model-Rregullores për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane.

II.

Vënia në Diskutim Publik e Model-Rregullores për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga Institucionet, ekspertët e fushës përkatëse dhe qytetarët, në mënyrë që e njëjta të jetë sa më funksionale për subjektet implementuese dhe të tjerët.

III.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

IV.

Vendimi bëhet transparent përmes Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim të Komunës së Deçanit.

01.Nr.X-5

Deçan, dt.30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (c), nenit 34 paragrafi 34.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019, për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 19 dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, bie këtë:

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE

I.

Formohet Komisioni për zgjedhjen e Këshillave Lokale, në këtë përbërje:

1. Fekri Qufaj, anëtar nga Kuvendi (AAK),
2. Afrim Demhasaj, anëtar nga Kuvendi (AAK),
3. Miftar Ahmetxhekaj, anëtar nga Kuvendi (LDK),
4. Faton Selmanaj, anëtar nga Kuvendi (LVV),
5. Jashar Dobraj, anëtar nga Ekzekutivi,
6. Safete Gacaferi, anëtare nga OJQ
7. Një (1) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e Këshillit Lokal.

Mbledhjen e parë të Komisionit e fton Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje Komisioni e zgjedhë kryesuesin e vet nga radhët e veta.

II.

Komisioni është përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtarë të Këshillave Lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Komisioni nëpërmjet Zyrës për Informim informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes: shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet për zgjedhjen e këshillave lokale; mediave lokale, Web – faqes zyrtare të komunës dhe Platforma tjera të komunikimit. Pas përfundimit të krejt procesit zgjedhorë, Komisioni raporton para Kuvendit të Komunës për procesin zgjedhor.

III.

Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e kuvendit të Komunës.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

V.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

VI.

Me Vendim paisen të emëruarit në pikën I.të Vendimit, Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Arhivi.

01.Nr.X-6

Deçan, dt.30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Duke u bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (i) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, sipas neni 26 pika 6 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, bazuar në Ligjin për Sistemin e Adresave, Nr.04/L-071 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.29/ 27 Dhjetor 2011), Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.14/2019 për Caktimin e Emërimit dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira, me Rekomandimin e Komisionit Komunal për Emërimin dhe Riemërimin e rrugëve, Shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Deçanit, të dt.22.06.2022, si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, nxjerrë këtë:

VENDIM

PËR EMËRIMIN DHE RI-EMËRIMIN E RRUGËVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

I

Aprovohet Rekomandimi I Komisionit për emërimin dhe ri-emërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit, sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

1. Në fshatin Carrabreg i Epërm, rruga e pa emëruar deri me tani, me gjatësi mbi 500 m, emërohet me emërin e veteranit të UÇK-së "Xhavit Dobraj".
2. Në qytetin e Deçanit, rruga e re e cila gjendet në mes të shkollës "Lidhja e Prizrenit" dhe QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, me gjatësi mbi 500 m, emërohet me emrin e Dëshmorit të Kombit "Halil Sejfiqaj".
3. Në fshatin Maznik rruga ekzistuese me emrin "Azem Sylaj", me gjatësi mbi 650 m. Riemërohet dhe zëvendësohet me emrin e rapsodit të ndjerë "Kushtrim Sylaj".
4. Në fshatin Prejlep rruga ekzistuese me emrin "Beteja", me gjatësi mbi 250 m. Riemërohet dhe zëvendësohet me emrin "Kreshnik Qufaj".

II.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

III.

Vendimi u dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë për Planifikimin Hapësinor, Agjensionit Kadastral të Kosovës, Entit Statistikor të Kosovës, Drejtorive Komunale, Zyrës për informim, Kryetarit të Komunës dhe Arkivit të Komunës.

01.Nr.X-8

Deçan, dt.30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, në bazë të nenit 3 paragrafi 1.4, paragrafi 1.12 dhe paragrafi 1.13, nenit 5, nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 dhe nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenit 14 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.10/03 Prill 2019, Sipas nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 22 dhe 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, nxjerrë këtë:

VENDIM PËR MIRATIM PARAPRAK TË VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË DERI (99) VITE TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I.

Merret vendimi PARAPRAK për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri (99) vite të pronës komunale sipas procedurave të përcaktuara me Ligjin nr.06/L-092.

Vendimi PARAPRAK vlenë: për parcelën nr.01256-0 me sipërfaqe 337 m², vendi i quajtur Fshati, shfrytëzimi aktual i parcelës Shtëpi-Ndërtesë, Zona kadastrale Deçan, për parcelën nr.01257-0 me sipërfaqe 25 m², vendi i quajtur Fshati, shfrytëzimi aktual i parcelës Shtëpi-Ndërtesë, Zona kadastrale Deçan, dhe për Pjesë nga parcela nr.04690-0 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7048 m², vendi i quajtur Fshati, shfrytëzimi aktual i parcelës Oborr, Zona kadastrale Deçan.

II.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën I. të këtij vendimi është për zhvillimin e veprimtarive ekonomike afariste, që nuk cenojnë rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin dhe që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

III.

Afati kohorë i dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim është afatgjatë, për periudhën deri 99 vite dhe bëhet përmes shprehjes së interesit.

IV.

Për zbatimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë deri 99 vite kujdeset Komisioni Vlerësues që formohet me vendim të veçantë të Kuvendit.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Komisioni Vlerësues, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

VI.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.X-10

Deçan, dt.30.06.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Stampa e Kuvendit të Komunës së Deçanit me datë 07.07.22 dhe numër 23242.



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, në bazë të nenit 17 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.10/03 Prill 2019, Sipas nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I.

Formohet Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, në përbërje prej (5) anëtarëve:

1.Shkodran Mustafaj, (nga Kuvendi), 2.Leotrim Hadergjonaj, (nga Kuvendi), 3.Hasan Hulaj (nga Ekzekutivi), 4.Izet Zenuni (nga Ekzekutivi) 7.Jehona Dabiqaj, (nga sektori jo qeveritar lokal).

Mbledhjen e parë të Komisionit e thirrë Kryesuesi i kuvendit, në të cilën mbledhje komisioni e zgjedhë kryesuesin nga radhët e veta.

II.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioni Vlerësues janë: Caktimi i Kryesuesit të komisionit, përpilimi dhe publikimi i njoftimit për shprehjen e interesit me të gjitha të dhënat për pronën e paluajtshme të Komunës që epët në shfrytëzim afatgjatë deri 99 vite, marrja pjesë në hapjen publike të ofertave, vlerësimi final i ofertës më të favorshme ekonomike, në pajtim me kriteret e përcaktuara me njoftimin për shprehjen e interesit, dërgimi në Kuvendin e Komunës për miratim të ofertës së përzgjedhur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, si dhe çështje të tjera, të cilat konsiderohen të rëndësishme nga Komisioni vlerësues.

III.

Komisioni ka mandat për zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për parcelën nr.01256-0 me sipërfaqe 337 m², vendi i quajtur Fshati, shfrytëzimi aktual i parcelës Shtëpi-Ndërtesë, Zona kadastrale Deçan, për parcelën nr.01257-0 me sipërfaqe 25 m², vendi i quajtur Fshati, shfrytëzimi aktual i parcelës Shtëpi-Ndërtesë, Zona kadastrale Deçan, dhe për Pjesë nga parcela nr.04690-0 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7048 m², vendi i quajtur Fshati, shfrytëzimi aktual i parcelës Oborr, Zona kadastrale Deçan.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.


Me nga një kopje të Vendimit do të paisen të emruarit në pikën I. dhe Arhivi.

01.Nr.X-10/1

Deçan,dt.30.06.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ





Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, me propozimin e Drejtorisë për Arsim, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.06.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E 20,000.00 € PËR BURSA TË STUDENTËVE TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN AKADEMIK 2020/2021

I.

Me këtë vendim ndahen 20,000.00 euro për bursa të studentëve si dhe bëhet formimi i Komisionit për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Deçanit për vitin akademik 2020/2021, në këtë përbërje:

1. Armend Loshaj, nga Asambleja (AAK), 2. Hyri Dobrunaj, nga Asambleja (LDK), 3. Manjolla Shala, nga Ekzekutivi, 4. Zeqë Malaj, nga Ekzekutivi –DKA, 5. Rexhep Daci, OJQ.

Komisioni e zgjedhë kryesuesin nga radhët e veta në mbledhjen e parë e cila thirret nga Kryesuesi i Kuvendit.

II.

Komisioni shumë prej 20,000.00 euro – Subvencione nga zyra e Kryetarit ose Drejtorisë për buxhet dhe financa do ta ndajë në përpjestim të barabartë me numrin e studentëve që do të përfitojnë në bazë të dokumnetacionit që ofrojnë për të qenë përfitues të bursës. Poashtu komisioni është përgjegjës për zhvillimin e të gjitha procedurave për ndarjen e bursave për student për vitin akademik 2009/2021. Komisioni cakton kushtet dhe kriteret për të qenë përfitues i bursës, përgaditë aplikacionin dhe hapë konkursin publik. Pas skadimit të afatit të konkurimit, komisioni është i obliguar të bëjë vlerësimin e kërkesave . Komisioni gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave do të percaktoj vetë metodën e punës dhe mënyrën e selekcionimit të kërkesave, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara paraprakisht.

III.

Komisioni pas zhvillimit të gjitha procedurave dhe permbylljes së procesit të perzgjedhjes së kandidateve përfitues, e nxjerrë listën përfundimtare të përfituesve dhe me raport e njofton Kryetarin e Komunes dhe Kuvendin e Komunes.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria për Arsim.

V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.


VI.

Me Vendim pajisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Drejtoria për Arsim, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.X-11

Deçan,dt.30.06.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:
Hajdar SUTAJ




Në bazë të kërkesës së OVL-UÇK-së dega në Deçan dhe tri Shoqatat tjera të dalura nga Lufta e UÇK-së dega në Deçan, të dt.21.06.2022, nr.01-20796, për mbështetje financiare për aktivitetet e katër Shoqatave të dalura nga Lufta e UÇK-së dega në Deçan, në mbështetje të nenit 40.2 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 26 pika 3. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, merr këtë:

VEN DIM

PËR SUBVENCIONIMIN E KATËR SHOQATAVE TË LUFTËS SË UÇK-së DEGA NË DEÇAN

- I. Lejohen mjetet financiare për subvencionimin e Katër Shoqatave të dalura nga Lufta e UÇK-së-dega në Deçan: (OVL) Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së dega në Deçan 65,000.00 €, SHFD-Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve 2,000.00 €, SHIL-Shoqata e Invalidëve të Luftës 3,000.00 €, Shoqata e të Burgosurve Politik 1,500.00 €. Mjetet financiare ndahen për aktivitetet që do të zhvillojnë katër Shoqatat gjatë vitit 2022, **në vlerë totale 13.000,00 €**.
Me marrëveshjen e palëve mjetet financiare do të derdhen në Gjirollogarinë e Fondacioni Batalioni Gardist Shkelzen Haradinaj, me përfaqësues ligjor Ahmet Neziraj, me numer personal 1009280746, me llogarinë nr.1403000033775188, te Banka Ekonomike, nr.te biznesit 52005078.
- II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në kategorinë e Subvencioneve.
- III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e KK Deçan.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.
- V. Me vendim njoftohen:
 1. Katër Shoqatat e Luftës së UÇK-së dega në Deçan,
 2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
 3. Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.X-12
Dt.30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.06.2022, bie këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E GRUPIT TË ASAMBLISTËVE TË RINJË TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT

I.

Formohen grupi i Asamblistëve të rinjë të Kuvendit të Komunës së Deçanit me mandat 2021-2025, i cili do të merret me interesat e të rinjëve të komunës së Deçanit. Grup që sipas kriterit të moshës nën 30 vjeçare, e përbëjnë: **1.Armend Loshaj, 2.Hamid Zukaj, 3.Arjan Dobraj, 4.Lendita Berisha, 5.Elmedina Sadikaj, 6.Floriana Hulaj, 7.Vatan Istrefaj, 8.Shkelqim Tolaj, 9.Blinera Lokaj, 10.Teuta Neziraj.**

Mbledhjen e parë të Grupit e thirrë kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje grupi e zgjedhë kryesuesin e vet nga radhët e veta.

II.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset:Kryesuesi i Kuvendit.

III.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, dhe Arhivi.

01.Nr.X-13

Deçan,dt.30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të kërkesës së Komunitetit të fshatit Ratishë i Ulët, të dt.24.01.2022, nr.02-2772, për shëndrrimin e objektit të ambulantes së fshatit, nga objekt i ambulantes në objekt të përbashkët në përdorim, për nevoja të gjithë fshatit, duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 15 dhe nenin 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.06.2022, bie këtë:

V E N D I M

PËR SHËNDRIMIN E PËRDORIMIT TË OBJEKTIT TË AMBULANTËS SË FSHATIT NË PËRDORIM TË OBJEKTIT PËR NEVOJA TË PËRBASHKËTA TË FSHATIT RATISH I ULËT

I.

Me këtë Vendim bëhet shëndrrimi i përdorimit të objektit të ambulantes së fshatit Ratish i Ulët, nga objekt i ambulantes në objekt për përdorim të përbashkët për nevojat e komunitetit të fshatit Ratish i Ulët.

A r s y e t i m:

Këshilli Organizativ i fshatit Ratish i Ulët i janë drejtuar organeve komunale me kërkesë që objekti i ambulantes së fshatit të shëndrrohet në objekt të përbashkët për përdorim për nevojat e gjithë fshatit, me arsyetimin se Ambulanta e fshatit qe një kohë të gjatë është jasht funksionit, aty nuk ka punonjës medicinal dhe nuk ka as pacientë që e frekuentojnë, poashtu objekti është e vjetruar dhe ka nevojë të rinovohet sepse dita ditës po shkatërrohet ashtu siç është i pa përdorshëm nga askush.

II.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bëjnë Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi në mungesë të mjeteve buxhetore nuk mund të zbatohet para muajit shtator.


IV.

Me Vendim njoftohen: Zyra e kryetarit, Drejtoria për Administratë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.X-14

Deçan, dt.30.06.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Bazuar në Ligjin Nr.08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.13 / 31 Dhjetor 2021), sipas nenit 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE BUXHETORE NË KATEGORINË E INVESTIMEVE KAPITALE nga projekti”Penda e ujit Vranoc”

I.

Merret Vendimi për Rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore në kategorinë e Investimeve Kapitale të vitit fiskal 2022, sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

1. **Mjetet financiare për rialokim dhe transfer nga projekti”Penda e ujit Vranoc” me projekt kod 10/631/18015/300/51502/045 në vlerë prej 65,000.00 €, grant i përgjithshëm, këto mjete (65,000.00€) rialokohen dhe transferohen në projektin e ri “Rinovimi i Objektivit të Zjarrfikësve”.**

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike të Komunës së Deçanit.

III.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.X-15/1
Deçan,dt.30.06.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Bazuar në Ligjin Nr.08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.13 / 31 Dhjetor 2021), sipas nenit 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE BUXHETORE NË KATEGORINË E INVESTIMEVE KAPITALE nga projekti “Ndërtimi i Objektivit të Kolonisë së Artistëve”

I.

Merret Vendimi për Rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore në kategorinë e Investimeve Kapitale të vitit fiskal 2022, sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

1. Mjetet financiare për rialokim dhe transfer nga projekti “Ndërtimi i Objektivit të Kolonisë së Artistëve” me projekt kod 10/631/18015/300/51479/045 në vlerë prej 60,000.00 €, grant i përgjithshëm, këto mjete (60,000.00€) rialokohen dhe transferohen në projektin ekzistues “Instalimi dhe zgjerimi i ndriçimit eficient në Deçan” me projekt kod 10/631/18015/30/52181/0451.

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike të Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.X-15/2
Deçan, dt.30.06.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN OPSTINA DEÇAN	
Nr. i vendimit 01	Nr. i regjistrimit 22833
Data 30.06.2022	



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

[Handwritten signature of Hajdar SUTAJ]



Bazuar në Ligjin Nr.08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.13 / 31 Dhjetor 2021), sipas nenit 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE BUXHETORE NË KATEGORINË E INVESTIMEVE KAPITALE nga projekti "Paisje dhe inventar në QKMF dhe AMF"

I.

Merret Vendimi për Rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore në kategorinë e Investimeve Kapitale të vitit fiskal 2022, sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

1. Mjetet financiare për rialokim dhe transfer nga projekti "Paisje dhe inventar në QKMF dhe AMF" me projekt kod 10/631/73900/300/51349/0721 në vlerë prej 49,000.00 €, grant i përgjithshëm, këto mjete (49,000.00€) rialokohen dhe transferohen në -Mirëmbajtje investive, Blloku kodues 10/631/73900/300/00000/0721, projekt i ri, për:

- Renovimi i brendshëm i objektit dhe rregullimi i nyjeve sanitare.

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Deçanit.

III.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.X-15/3
Deçan,dt.30.06.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ